

## Programi i Praktikave të Biznesit Gjerman

I nderuar zotëri/zonjë,

Po ju shkruaj këtë letër për t'ju informuar me **Programin e Praktikave të Biznesit Gjerman për Vendet e Ballkanit Perëndimor**.

Duke qenë se Programi i Praktikës është një mundësi e jashtëzakonshme për të fituar njohuri praktike për çdo student nga Kosova, ne kemi vendosur të kontaktojmë profesorët e këtij vendi. Studentët e fakultetit tuaj më sygjëruan që t'ju shkruaja juve duke më dhënë kontaktet tuaja për t'ju paraqitur kërkesën time.

Programi i Praktikave të Biznesit Gjerman ([www.stipendienprogramm.org](http://www.stipendienprogramm.org)) ndihmon studentët dhe të diplomuarit e rinj që të fitojnë përvojën e parë të punës në kompanitë lider në Gjermani. Gjatë 18 viteve të fundit, ne kemi mbështetur më shumë se 830 studentë dhe të sapo diplomuar nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Kroacisë në këtë drejtim. Të gjithë ata kanë kaluar tre deri në gjashtë muaj në Gjermani, ku patën mundësinë të zgjerojnë njohuritë e tyre të fituara gjatë studimeve dhe t'i implementojnë ato në praktikë. Pas kthimit në vendet e tyre, të gjithë kanë arritur të gjejnë shumë shpejt punë mjaft të mira. Përveç kësaj, pjesëmarrësit në këtë program janë gjithashtu pjesë e një rrjeti rajonal të alumni-ve ku ata trajnohen vazhdimisht sipas nevojave të tregjeve lokale të punës.

Unë do ta vlerësoja shumë nëse ju do të mund të mbështesni programin tonë dhe t'u jepni studentëve tuaj informacionin e bashkangjitur. Do ju isha shumë mirënjohëse nëse mund t'ju prezantoni atyre thirrjen për aplikim. Nëse është e mundur, ne do të donim të shfrytëzonim rastin për t'ua prezantuar programin studentëve tuaj. Për shkak të pandemisë aktuale, ne, për fat të keq, duhet ta bëjmë këtë në mënyrë virtuale. Ne do të ishim shumë të interesuar të prezantoni Programin tonë në bashkëpunim me ju.

### Träger

Bundesverband der Deutschen  
Industrie e.V.

Deutscher Industrie- und  
Handelskammertag e.V. (DIHK)

Bundesverband deutscher Banken e.V.

BGA – Bundesverband Großhandel,  
Außenhandel, Dienstleistungen e.V.

Gesamtverband der Deutschen  
Versicherungswirtschaft e.V.

Zentralverband des Deutschen  
Handwerks e.V.

Gjenerata e ardhshme e kandidatëve që do të fitojnë bursën, do e fillojë praktikën më 1 Korrik 2022. Thirrja për aplikime vazhdon të jetë e hapur nga **1 Tetori 2021** deri më **16 Nëntor 2021**. Studentët mund të informohen për benefitet që ka ky program dhe për procedurën e aplikimit në faqen tonë të internetit: [www.stipendienprogramm.org](http://www.stipendienprogramm.org)

Për shkak të situatës pandemike, këtë vit nuk është e mundur që përfaqësues të programit të jenë fizikisht në fakultetin tuaj për të bërë prezantimin. Prandaj, ju paraqes datat e mëposhtme për dy takime informuese virtuale:

\* 21, Tetor, 14h

<https://us06web.zoom.us/j/85910718398?pwd=bTVKMVdYMIJZ2UyclNuSnhXa1dvQT09>

Meeting ID: 859 1071 8398

Passcode: 704098

\* 28. Tetor, 18h

<https://us06web.zoom.us/j/89042993248?pwd=K2R0cys5ZnAyVW84Q1p3aFhoeMFKdz09>

Meeting ID: 890 4299 3248

Passcode: 703431

Gjishashtu, të bashkangjitur në këtë email po ju dërgoj një broshurë që mund të shpërndahet përmes adresave të email-it të studentëve ose në faqen e internet të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike.

Nëse keni ndonjë pyetje shtesë në lidhje me Programin, ju lutem mos hezitoni të më kontaktoni mua.

Shpresoju shumë në bashkëpunimin me ju në këtë drejtim.

Me respekt,



Antje Müller

Drejtoreshë e Programit